

D E K R E T
Nr.886, datë 12.7.1994

**PËR DHËNIE KREDIE BANORËVE TË ZONAVE TË PËRMBYTURA NGA NDËRTIMI I
HIDROCENTRALEVE NË RRETHET KUKËS, HAS, TROPOJË DHE PUKË**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491 datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Banorëve të zonave të përmbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Has, Kukës, Tropojë dhe Pukë që kanë marrë tokë bujqësore në zonën e caktuar nga komisionet në rrethe, të ngritura për këtë qëllim, u jepet kredi për strehim nëpërmjet Bankës Tregtare Agrare, e cila do të jetë në rolin e agjentit, me kushtet që përfitojnë të pastrehët në zonat urbane sipas ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

Neni 2

Familjet që pas shpronësimit si rezultat i përmbytjes janë sistemuar nga shteti dhe privatizimi i banesës ekzistuese të tyre është bërë pa pagesë, përfitojnë kushtet sipas nenit 1 të këtij dekreti, pasi banesa të jetë vënë në dispozicion të pushtetit lokal.

Neni 3

Masa e kredisë të jetë deri 150.000 lekë për çdo pjesëtar të familjes.

Neni 4

Kostoja e administrimit të këtyre kredive nga Banka Tregtare Agrare të përballohet nga vetë kjo bankë.

Neni 5

Komisionet e ngritura në rrethe e komuna bëjnë kategorizimin e familjeve sipas neneve 1 dhe 2 të këtij dekreti, pasi të bëjnë verifikimin e kërkesave dhe ia dorëzojnë bankës për zbatim.

Neni 6

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Sali Berisha